



KLAN KOSOVA
Baton HAXHIU
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/125, 205, 209 dhe 216 KPM vs Klan Kosova
Ref:1711/1272/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën Nr. 2017/125, 205, 209 dhe 216 – Komisioni i Pavarur i Mediave
(KPM) kundër Klan Kosova (“Pala Përgjegjëse”)**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 18 shkurt 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
3. Pala Përgjegjëse me Vendim të Komisionit të KPM të datës 10 gusht 2017 është dënuar me Vërejtje për shkeljet e bëra gjatë fushatës zgjedhore në Zgjedhjet e Përgjithshme 2017 në Republikën e Kosovës, duke transmetuar spote politike me prezencë të fëmijëve dhe gjatë heshtjes zgjedhore duke transmetuar konferencë të një subjekti politik ku është parë slogani i tij.
4. KPM me datën 21 shtator 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t’i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore në Zgjedhjet Lokale 2017 në Republikën e Kosovës.
5. KPM ka bërë monitorimin e programit të Palës Përgjegjëse që nga fillimi i fushatës zgjedhore për të verifikuar pajtueshmërinë me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr.

03/L-073 dhe me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës .

6. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 10 tetor 2017, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spotin politik të subjektit politik AAK, në të cilin ishin të përfshirë fëmijët. Po ashtu, të njëjtin spot politik nuk e ka identifikuar si spot me pagesë apo pa pagesë dhe nuk e ka identifikuar se nga kush është sponsorizuar.
7. KPM në bazë të të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 11 tetor 2017, i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke e udhëzuar të veprojë në pajtim me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet dhe me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës.
8. KPM në bazë të raportit të monitorimit të datës 19 tetor 2017 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë edhe shkelje tjera gjatë fushatës zgjedhore, duke transmetuar spotin politik të subjektit politik AKR në kohëzgjatje prej 10 minuta e 25 sekonda.
9. KPM në bazë të të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 19 tetor 2017 i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse duke i kërkuar të ndërpresë menjëherë transmetimin e spotit politik më të gjatë se dy minuta dhe edhe një herë duke i bërë me dije që dështimi për të vepruar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet do të rezultojë me inicimin e procedurave ligjore sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse.
10. KPM ndaj Palës Përgjegjëse ka pranuar edhe një ankesë nga z. Xhavit Drenori, kandidat për Kryetar në Komunën e Drenasit. Në ankesë theksohet se Pala Përgjegjëse nuk e ka ftuar në DEBATIN PËR DRENASIN, të organizuar me datën 17 tetor 2017, ku janë paraqitur të ftuarit e tjerë si të vetmit kandidatë dhe nuk e kanë sqaruar mospjesëmarrjen e tij në debat, duke i shkaktuar dëm të pariparueshëm në garën zgjedhore.
11. KPM me datën 18 tetor 2017 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse me ankesën e z. Drenori dhe ka kërkuar sqarim lidhur me të.
12. KPM ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse me datën 19 tetor 2017, duke pretenduar se për shkak të rrethanave teknike është vendosur që të ftohen nga gjashtë kandidatë dhe se z. Drenorit i është ofruar mundësia të shkojë në emisionin Sytë 7, që zgjatë 20 minuta.
13. KPM pas analizimit të pretendimeve të Palës Ankuese dhe përgjigjes së Palës Përgjegjëse ka gjetur se pala ankuese nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në raport me të gjithë kandidatët tjerë për kryetar komune. KPM në bazë të të gjeturave, me datën 19 tetor 2017, i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse, duke i kërkuar që menjëherë t'i mundësojë z. Drenori përfaqësim të drejtë dhe të barabartë, duke i ofruar hapësirë për paraqitjen e pikëpamjeve politike në programet me diskutime politike dhe debate.

14. KPM në bazë të raportit të monitorimit të datës 23 tetor 2017 ka gjetur se Pala Përgjegjëse deri në përfundim të fushatës zgjedhore nuk ia ka dhënë z. Drenori mundësinë e paraqitjes së pikëpamjeve politike në programet me diskutime politike dhe debate.
15. KPM po ashtu, bazuar në raportin e monitorimit të datës 23 tetor 2017, ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë heshtjes zgjedhore, më 22 tetor 2017, ka transmetuar deklarata të përfaqësuesve të partive politike si: SRPSKA LISTA, PDK dhe LDK të cilët iu kanë bërë thirrje specifike për votim përkrahësve të partive të tyre. KPM në bazë të të gjeturave, me datën 24 tetor 2017, Palës Përgjegjëse i ka dërguar Njoftim për Shkelje.
16. KPM me datën 25 tetor 2017 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse, me pretendimin se deklaratimet e përfaqësuesve të partive politike janë transmetuar direkt dhe se kur është konstatuar se ata po bëjnë thirrje specifike e kanë ndërprerë transmetimin dhe se kështu kanë vepruar edhe në Zgjedhjet e Përgjithshme.

Analiza Ligjore

17. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës.
18. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spotin e subjektit politik AAK, në të cilin ishin të përfshirë fëmijët, duke bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”

Po ashtu, të njëjtin spot politik nuk e ka identifikuar si spot me pagesë apo pa pagesë dhe nuk e ka identifikuar se nga kush është sponsorizuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.”

19. Komisioni po ashtu konstaton se Pala Përgjegjëse ka transmetuar një spot politik me pagesë të subjektit politik AKR në kohëzgjatje prej 10 minuta e 25 sekonda, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Pikat reklamuese politike nuk janë më të gjata se dy (2) minuta (120 sekonda).”

20. Komisioni gjithashtu konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjitha subjektet politike të certifikuara, respektivisht kandidatët e tyre për kryetarë komunash. KPM në lidhje me trajtimin jo të barabartë ka pranuar një ankesë nga z. Xhavit Drenori kandidat për Kryetar në Komunën e Drenasit. Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për Shkelje të dërguar nga KPM, ka dështuar t'i ofrojë drejtën për përfaqësim të drejtë dhe të paanshëm z. Drenori, duke vepruar kështu në kundërshtim me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht me nenin 48, i cili përcakton se:

“Të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së zgjedhjeve, dhe të gjitha mediat transmetuese u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime politike dhe debate.”

21. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë edhe shkelje të heshtjes zgjedhore, duke transmetuar deklarata të përfaqësuesve të partive politike si: SRPSKA LISTA, PDK dhe LDK të cilët iu kanë bërë thirrje specifike për votim përkrahësve të partive të tyre, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.”

22. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës.

Vendimi

23. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës, shkelje të nenit 48, nenit 49, paragrafi 1 dhe 6 dhe nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
24. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së sanksionon me gjobë në vlerën prej 5,000 (pesëmijë) euro Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Shërbimet Mediale në Republikën e Kosovës dhe shkelje të nenit 48, nenit 49, paragrafi 1 dhe 6 dhe nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

E drejta për Ankesë

25. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa

bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

26. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



08.11.2017
Datë